GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

KËRKESA NR. 616/16
DORIAN MATLIJA
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 5 tetor 2021, si Komision, i përbërë nga:

María Elósegui, *kryetare,*
Darian Pavli,
Frédéric Krenc*, gjyqtarë,*
dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 14 dhjetor 2015,

duke marrë në konsideratë deklaratat formale, në të cilat pranohet një zgjidhje miqësore për çështjen,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkuesi, z. Dorian Matlija, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1976, i cili jeton në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj periudhe, z. E. Muçaj, dhe më pas nga znj. B. Lilo, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Qeverisë iu komunikuan ankesat e kërkuesit, në mbështetje të neneve 6§1, 10 dhe 13 të Konventës për mosrespektimin nga ana e autoriteteve të një vendimi të formës së prerë të brendshëm, sipas së cilit autoritetet urdhëroheshin të paraqisnin dokumente që vërtetonin se kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik përmbushnin kriteret statutore për emërimin e tyre në një zyrë publike.

4. Gjykata mori deklaratat për një zgjidhje miqësore, të nënshkruara nga palët, sipas së cilave kërkuesi binte dakord të hiqte dorë nga pretendime të mëtejshme ndaj Qeverisë së paditur, në lidhje me faktet që sollën këtë kërkesë, me kusht që Qeveria t'i ofronte atij brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës, informacionet që u urdhëruan të jepeshin në vendimin e gjykatës vendëse, të ruajtura në arkivat e institucioneve përkatëse shtetërore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, arkivat e kryeministrisë dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, me përjashtim të certifikatave të gjendjes gjyqësore, të cilat ishin shkatërruar për shkak të periudhave të kufizuara për ruajtjen e tyre.

5. Gjithashtu, Qeveria pranoi t'i paguante kërkuesit 5,000 EUR, për të paguar dëmin jomonetar, së bashku me kostot dhe shpenzimet, plus ndonjë taksë që mund t'i tarifohej, të cilat do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatuar në datën e pagesës, dhe do të paguhen brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria pranon të paguajë interesin e thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barabartë me normën margjinale të huas së Bankës Qendrore Evopiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë përqindje.

LIGJI

6. Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo pranon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye që justifikojnë një shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:

Vendos, ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 nëntor 2021.

Olga Chernishova	**Marta Elósegui**
Zëvendësregjistrare	Kryetare